



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.181/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Kujtim Pasuli e Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren, kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren, Anr.181/2025 e datës 24.01.2025
- II. Subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkak të mbajtjes së tubimeve në objekte publike pa autorizim, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1,500.00(njëmijë e pesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik Nasa Bosnjačka Koalicija, me seli në Prizren të parashtruar kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren, për shkelje të nenit 2.1 të Rregullores për Procesin Zgjedhor, i cili ndalon angazhimin e të punësuarve në institucione shtetërore dhe publike gjatë orarit të rregullt të punës, përveç nëse janë kandidatë që kanë pezulluar marrëdhëniet e punës dhe në këtë rast, Emilia Rexhepi si zëvendëskryeministre ka qenë e pranishme në një ngjarje politike gjatë orarit të punës, gjë që paraqet shkelje e kësaj rregulloreje. Sipas pretendimeve në ankesë pretendohet se më 23 Janar 2025, gjatë vizitës në Komunën e Istogut, me të cilën ishin të pranishëm Emina Çoković

(kandidate për deputete), Emilija Rexhepi (zëvendës kryeministër dhe kandidate për deputete), Avdullah Djeseviq (kandidat për deputet), besojnë se kanë pasur shkelje të rregullores zgjedhore, pikërisht në pikën 2.1, me të cilën ndalon përdorimin e të punësuarave në institucionet e sektorit publik si pjesë e aktiviteteve parazgjedhore gjatë orarit të punës. Në rastin konkret parashtruesi i ankesës theksohet se të njëjtit kandidat kanë qenë të pranishëm gjatë orëve të mësimit (orën e parë e turnit të dytë) e nëpunësve publik dhe liderëve politik, dhe liderëve në Institucionin Shkollor “Fan Noli” në Dobrushë, paraqet abuzim të qartë të objekteve me qëllim promovimin parazgjedhor, që është në kundërshtim me rregulloret dhe normat ligjore. Pala ankuese thekson se kjo nuk është hera e parë që zëvendëskryeministrja përdor shkollat në periudhën parazgjedhore, dhe se në ditët e ardhshme të fushatës, ka një njoftim se do të shfrytëzoj gjatë orarit të punës hapësirat publike të shkollës për tu takuar me punëtorët e arsimit.

Pala ankuese po ashtu thekson se kërkojnë nga organet kompetente përfshirë edhe PZAP-i dhe Komisionin për Organizimin dhe Kontrollimin e Zgjedhjeve (KKZ), që të merren masat e duhura ndaj partisë politike Partia e Re Demokratike dhe anëtarëve të saj për këto shkelje.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur katër fotografi dhe një link.

Në përgjigje në ankesë të datës 25.01.2025 nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka, theksohet se vizita e zëvendëskryeminstres në shkollë nuk ka pasur asnjë qëllim politik dhe se nuk ka përfaqësuar ndonjë formë promovimi apo propagande politike. Më tutje në përgjigje në ankesë pretendohet se qëllimi i vizitës u realizua me qëllim të konsultimit me administratën e shkollës, duke pasur parasysh kontaktet e vendosura më parë në lidhje me projektin e planifikuar të ndërtimit të një objekti të ri shkollor dhe se vizita u realizua sipas një agjende të paracaktuar, para fillimit të fushatës dhe se nuk ishte pjesë e aktivitetit politik, por njoftim paraprakisht për renovimin e shkollës dhe se qytetarët kanë kërkuar që në muajin janar të mbahej një takim tjetër, i cili rezultoi me këtë vizitë. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se gjatë vizitës nuk u përdorën simbole, slogane apo materiale promovuese të partisë politike, as në këtë takim dhe as në takimet e mëparshme nuk është folur për parti apo zgjedhje, dhe as fëmijët nuk janë përfshirë në ndonjë aktivitet politik dhe se takimi kishte karakter ekskluzivisht informativ, lidhur me projektet e planifikuara infrastrukturore në arsim. Po ashtu në përgjigje në ankesë pretendohet se vizita e shkollës nuk ishte planifikuar apo raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si një tubim promovues, pasi nuk kishte natyrë politike, nuk ka pasur thirrje publike, fjalime politike apo tubime të qytetarëve me qëllim të promovimit të ndonjë partie politike, zëvendëskryeministrja ka vizituar shkollën sipas aktiviteteve të parapara, para fushatës zgjedhore, dhe se kjo vizitë u bë në kuadër të një nisme më të gjerë për përmirësimin e objekteve shkollore në komunën e Pejës, siç u konfirmua nga takimet e mëparshme zyrtare me institucionet arsimore. Më tutje në përgjigje në ankesë konkludohet se vizita u zhvillua në përputhje të plotë me kornizën institucionale dhe nuk përmbante elemente të një fushate politike. Në vazhdim theksohet se besojnë se të gjitha aktivitetet ishin në interes të komunitetit dhe në përputhje me nevojat e tij, andaj, duke marrë parasysh faktet e paraqitura, besojnë se ky raport është pjesë e një përpjekjeje dashakeqe të kundërshtarëve politikë për të përdorur fushatën aktuale politike për të etiketuar dhe diskredituar pa bazë Zëvendëskryeminstren dhe opsionin e saj politik.

Në përgjigjen e tyre në ankesë theksojnë se pretendime të tilla janë të pasakta, të pabaza dhe paraqesin një përpjekje për shpifje që nuk ka bazë në fakte dhe se të gjitha të dhënat e

lartpërmendura mund t'i konfirmojmë përmes dëshmitarit të Këshillit të Prindërve të shkollës, Ç. M. nga Dobrusha, e cila ka marrë pjesë në të gjitha takimet dhe mund të konfirmojë saktësinë e deklaratave tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se fotografit e bashkuara nga ankesë dhe nga linku në llogarinë e facebook-ut të zëvendës kryeministres dhe kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka, Emilija Rexhepi. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik Nova Boshnjaqka, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik, Nova Demokratska Stranka, është shkëlur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatët në fjalë, me qëllim të bërjes së fushatës, është regjistruar në institucione shtetërore dhe ky postim është ende aktive edhe gjatë fushatës zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “ *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave* ”.

Edhe pse sipas përgjigjes së dhënë në ankesë pretendohet se kandidatë për deputete nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka, ka shfrytëzuar hapësirën e institucioneve shtetërore me qëllim të konsultimit me administratën shtetërore, për shkak të kontakteve të mëparshme për projektin e planifikuar për ndërtimin e objektit të ri shkollor, mirëpo sipas vlerësimit të panelit me qenë se ky postim është publikuar në facebook dhe vazhdon të jetë aktiv në facebook, në llogarinë e kandidatës për deputete Emilija Rexhepi, andaj paneli vlerëson se është objekti i shkollës në fjalë është duke u përdorur edhe gjatë fushatës zgjedhore e me qëllim të përfitimit të votave, në kundërshtim me nenin 4 të rregullores zgjedhore 7/2024, pasi që nuk ka dëshmi që paraprakisht të ketë siguruar lejen nga institucioni përkatës dhe KKZ.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatës për deputetet Emilija Rexhepi, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenin 4 paragrafi 2 rregullores zgjedhore 07/2024.

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në subjekti politik Nova Demokratska Stranka, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e postimeve për fushatë zgjedhore në ambiente të institucionit, në këtë rast të shkollës Fan Noli, e që përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.181/2025 më datën 27.01.2025

Kryesuese e Panelit

Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.